

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-53/12

Prishtinë, 23 maj 2013

Në çështjen juridike të:

M.D.S

Praraqitësi i kërkesës/Ankuesi

kundër

1. XH.M

2. A.Sh.K

Palët përgjegjëse/Palët përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, Anëtar, duke vendosur me ankesat kundër vendimeve të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/R/131/2011 (lënda është regjistruara në AKP me numrin 53997), i datës 26 tetor 2011 dhe KPCC/D/A/128/2011 lënda je regjistruar në AKP me numrin 53998 i datës 26 tetor 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 23 maj 2013, morri këtë:

AKTGJYKIM

- 1- Ankesat e paraqitura nga M.D.S me datë 23 mars 2012 dhe të regjistruara me numrat GSK-KPA-A-53 /12 dhe GSK-KPA-A-54/12 janë bashkuar në një lëndë të vetme me numër GSK-KPA-A-53/12.
- 2- Refuzohen si të pabazuara ankesat e paraqitura me datë 23 mars 2012 nga M.D.S.
- 3- Konfirmohen vendimet KPCC/D/R/131/2011 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA53997), i datës 26 tetor 2011 dhe KKPK/D/A/128/2011 (lënda është regjistruar në AKP me numrin KPA53998), i datës 26 tetor 2011.
- 4- Obligohet pala ankuese që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej € 60 (gjashtëdhjetë) brenda afatit prej 90 (nëntëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve procedurale dhe faktike:

Me 8 nëntor 2007, M.D.S ka paraqitur 2 (kërkesa) në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), duke kërkuar konfirmimin e së drejtës së pronësisë të disa ngastrave dhe ri-posedimin. Ai ka shpjeguar se këto ngastra kadastrale kanë qenë në emërim e nënës së tije L.S dhe të cilat ishin uzurpuar.

Për ta mbështetur kërkesën e tij, ai ka paraqitur në AKP dokumentet si në vijim:

- Përgjigjen e titullares së të drejtës së pronësisë Ljubica Stojanović ndaj palës përgjegjëse në kërkesë e datës 20 shtator 2011;
- Deklaratën e L.S në cilësinë e titullarës së të drejtës së pronësisë e datës 30 dhjetor 2009 të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë Vr.nr.9680, e cila i deklaratë i referohet shitjes së paluajshmërisë së regjistruar në fletën poseduese nr. 36 të Komunës Kadastrale Shaptej, Komuna e Deçanit A.Sh.K me vetëdije të plotë pa përdorimin e dhunës, mashtrimit, lajthimit dhe kërcënimit madje me pëlqim të familjes së sajë.
- Leternjoftimin e lëshuar me datë 14 shkurt 1985, nga Komuna e Gjakovës;
- Fleta Poseduese, Nr. 36, lëshuar me datë 14 maj 2005 nga Republika e Serbisë, me të cilën L.S është pronare e ngastrave të kërkuara në Komunën e Deçanit, Zona Kadastrale Shaptej, si në vijim:

Numri i ankesës dhe dosjes së lëndës së AKP-së	Të dhënat lidhur me ngastrën e kërkuar
GSK-KPA-A-53/12 (KPA53997)	Ngastra Nr. 43, në vendin e quajtur “Okuqnica”, livadh e kalasës së 4 me sipërfaqe 2.84.95ha, shtëpi në sipërfaqe prej 0.01.86ha, oborr me sipërfaqe prej 0.05.00 ha .

GSK-KPA-A-54/12 (KPA53998)	Ngastra Nr. 45, në vendin e quajtur “Parcela”, pemishte klasës së 2-të, me sipërfaqe prej 0. 22. 40 ha
GSK-KPA-A-54/12 (KPA53998)	Ngastra Nr. 46, në vendin e quajtur “Parcela”, arë klasës së 3-të, me sipërfaqe prej 1. 49. 31 ha
GSK-KPA-A-54/12 (KPA53998)	Ngastra Nr. 47, në vendin e quajtur “Parcela”, mal e klasës së 2-të, me sipërfaqe prej 0. 79. 97 ha
GSK-KPA-A-54/12 (KPA53998)	Ngastra Nr. 48, në vendin e quajtur “Parcela”, oborr e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 0. 19. 29 ha
GSK-KPA-A-54/12 (KPA53998)	Ngastra Nr. 49, në vendin e quajtur “Parcela”, livadh e klasës së 4-të, me sipërfaqe prej 0. 74. 76 ha
GSK-KPA-A-54/12 (KPA53998)	Ngastra Nr. 50, në vendin e quajtur “Parcela”, mal i klasës së 2-të, me sipërfaqe prej 1. 10. 43 ha

Prona e kërkuar sipas kërkesës të regjistruar KPA53997 lidhur me lëndën GSK-KPA-A-53/12 është njoftuar me 30 janar 2008 dhe me 19 shkurt 2009, ndërsa kërkesa KPA53998 sipas lëndës GSK-KPA-A-53/12 është njoftuar me 4 mars 2009 dhe 10 korrik 2009. Ekipi i AKP-së për njoftim, ka shkuar në vendet ku pretendohet se ndodheshin ngastrat e kërkuara dhe ka vendosur shenjat që tregojnë se pronat ishin objekt kontesti të kërkesave dhe se palët e interesuara duhet t'i paraqisinin përgjigjet e tyre brenda 30 ditëve.

Pala përgjegjëse Xh.M, me datë 24 dhjetor 2008, në përgjigjen e tij pretendon se pronat e kërkuara fillimisht deri në vitin 1954 kishin qenë në zotërim të familjes së tij. Në vitin 1954, D.S – bashkëshorti i bartëses së të drejtës pronësore i kishte marrë këto pronat dhe i kishte shfrytëzuar deri më 1998, dhe ai – Xh.M – i ka shfrytëzuar që nga ajo kohë. Ai kishte shprehur dëshirën e tij që të njëjtat t'i blejë nga paraqitësja e kërkesës. Për të mbështetur këto pretendime, ai ka paraqitur këto prova edhe atë:

- Tapinë në gjuhën origjinale si edhe atë të përkthyer;
- Deklaratat e A.Z dhe S.A e datës 15 qershor 1923 me të cilën konstatohet pranimi i çmimit të shitjes për pronat që gjinden në Dubravë.

Po kështu në cilësinë e palës përgjegjëse, me datën 4 mars 2009, është paraqitur A.Sh.K duke pohuar se i kishte blerë pronat që janë objekt i kërkesave me ç' rast ka paraqitur këto prova shkresore edhe atë:

- Autorizimin të vërtetuar në Gjykatën Komonale në Pejë Vr.nr.9679/09 i datës 30 dhjetor 2009 me të cilin autorizohet Q.M në Pejë nga L.S që në emër dhe për llogari të sajë t'i shet dorëzon dhe

regjistrojnë në organin kompetent N.K.43, 44,45,46,47,48,49, dhe 50 të regjistruara në f.p.36 të Zonës Kadastrale Shaptej, Komuna e Deçanit, blerësit A.Sh.K;

- Kontratë e shitblerjes së paluajshmërive të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Deçan Vr.nr 2996/09 e datës 31 dhjetor 2009;
- Para-Kontratën me deklaratën e titullarit të së drejtës së pronësisë L.S e vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë Vr.nr. 9880/09 e datës 30 dhjetor 2009, me të cilën konstatohet se ajo ia ka shitur A.Sh.K paluajshmërinë nga Fleta Poseduese nr. 36 të Zonës Kadastrale Shaptej, Komuna e Deçanit me çmim prej 175,000.00 Euro që është dashur të paguhet me këste dhe këto paluajshmëri janë shitur me vullnet të lirë, pa përdorimin e dhunës dhe mashtrimit;
- Përgjigjen e dhënë e titullarë e së drejtës së pronësisë adresuar AKP-ës e datës 16 shtator 2011 me të cilën pohon se ekziston kontesti në mes të sajë dhe A.Sh.K, ngase nuk ka vepruar sipas marrëveshjes që kanë pasur. Ndërkaq, pohimet e Xh.M janë të pabazuara dhe kanë për qëllim zaptimin e paluajshmërisë së sajë;
- Certifikatën e të drejtave të pronës së paluajshme UL-70505082-00036 e datës 19 korrik 2010 të Zonës Kadastrale Shaptej, Komuna e Deçanit, e cila është verifikuar pozitivisht, ndërkaq provat tjera nuk janë parë të nevojshme të verifikohen.

Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) në lidhje me pronat e kërkuara, me vendimin e tij KKPK/D/A/128/2011, dhe KKPK/D/R/131/2011 datës 26 tetor 2011, ka hedhur poshtë kërkesat e paraqitësit të kërkesave për shkak të mungesës së juridiksionit me arsyetim se ata kanë konfirmuar shitjen e pronave që është objekt i kërkesave, por kontrata nuk është përmbushur tërësisht meqenëse vetëm një pjesë e çmimit kontraktues është paguar. Prandaj nga këto arsye komisioni ka konsideruar se kërkesat e tilla i referohen kontestit kontraktues dhe rrjedhimisht paraqitësi i kërkesave respektivisht titullari i të drejtës së pronësisë kanë qenë në situatë juridike dhe faktike të ushtrijë të drejtat e pronësisë duke i shitur ato paluajshmëri dhe se nuk mund të thuhet që humbja e të drejtave pronësore ka qenë e ndërlidhur me rrethanat drejtpërdrejtë apo që rezultojnë nga konflikti i armatosur në vitin 1998/1999

Paraqitësi i kërkesës – ankuesit vendimi i është dorëzuar ankuesit me 27 shkurt 2012. Ndërkaq palës përgjegjëse A.Sh.K vendimi i është dorëzuar me 01 shkurt 2012. Me datën 02 shkurt 2012 Xh.M i është dorëzuar ky vendim. Me datë 16 maj 2012 A.SH.K dhe XH.M i kanë pranuar ankesat e ankuesit dhe nuk kanë dhënë përgjigje në ankesë.

Me 23 mars 2012, paraqitësi i kërkesave/ankuesi duke paraqitur ankesat në Gjykatën Supreme, i ka kundërshtuar vendimit e KKPK-së për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe

për shkak të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale me propozim që vendimet e Komisionit të ndryshohen dhe t'i pranohet e drejta e pronësisë në ngastrat që janë objekt i kërkesave. Më tej ai deklaroi se nëna e tij në cilësinë e titullarë të së drejtës së pronësisë nuk e ka nënshkruar autorizimin e vërtetuar nga Gjykata Komunale në Pejë VR.nr.9679/09 i datës 30.12.2009 dhe se i njëjti është i falsifikuar. Meqenëse nuk e ka shitur pronën që është objekt i kërkesave dhe humbja e sajë është e ndërlidhur drejtpërdrejtë apo rezulton nga konflikti i armatosur, ndaj ka kërkuar nga Gjykata Supreme që t'i kthehet posedimi i tyre sipas nenit 3 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079.

Gjykata Supreme i ka bashkuar kërkesat.

Arsyetim ligjor:

Bashkimi i ankesave:

Neni 13.4 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 mbi Zgjidhjen e Kërkesave lidhur me Pronën e Paluajtshme Private duke përfshirë Pronën Bujqësore dhe atë Komerciale, përcakton se Gjykata Supreme mund të vendosë për ankesat e bashkuara apo të shkruara, kur për bashkimin apo shkrirjen e kërkesave është vendosur nga Komisioni, në pajtim me nenin 11.3 (a) të kësaj Rregulloreje. Ky nen i mundëson Komisionit që të marrë në konsideratë bashkimin ose shkrirjen e kërkesave me qëllim të shqyrtimit dhe marrjes së vendimeve kur ekzistojnë çështje të përbashkëta ligjore dhe të provave.

Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën Civile të cilat janë të zbatueshme në procedurën e apelit pranë Gjykatës Supreme sipas nenit 12.2 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pastaj ato të nenit 408.1, në lidhje me nenin 193 të Ligjit Nr. 03/L006 mbi Procedurën Kontestimore, parashikojnë mundësinë e bashkimit me aktvendim të të gjitha padive nëse ky bashkim i kontribon efikasitetit dhe ekonomizimit të procedurës.

Në tekstin e ankesave të parashtruara nga ana e ankuesit, Gjykata Supreme konstaton se përveq numrit të ndryshëm të lëndës për të cilën saktësisht ushtrohet ankesa përkatëse, e gjitha baza faktike dhe ligjore, si dhe çështja e provave është plotësisht e njëjte në të dy lëndët. Vetëm parcelat, objekte të së drejtës pronësore, të cilat pretendohen në secilën kërkesë janë të ndryshme. Ankesat bazohen në deklaratën e njëjtë sqaruese dhe në dokumentacionin e njëjtë. Për më shumë edhe arsyetimi ligjor i dhënë nga ana e Komisionit për kërkesat është i njëjtë.

Ankesat e regjistruara nën numrat GSK-KPA-A-53/12 dhe 54/12, janë bashkuar në një lëndë të vetme të regjistruar nën numrin GSK-KPA-A-53/12.

Pranueshmëria e ankesave:

Gjykata Supreme e Kosovës aktgjykimin ankimor e shqyrtoi në pajtim me dispozitat e nenit 194 të LPK, dhe pasvlerësimi të thënjeve ankimore gjeti se:

Ankesat janë të pranueshme ngase janë paraqitur mbrenda afatit ligjor sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, ku parashikohet që pala mund të paraqesë ankesë kundër vendimit të Komisionit brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve për vendimin. Kjo për arsye se vendimi i është dorëzuar ankuesit me 27 shkurt 2012 dhe se i njëjti me 23 mars 2012 ka paraqitur ankesë. Mirëpo ankesat nuk janë të bazuara.

Gjykata Supreme e Kosovës vendimin e KKPK-ës me të cilin është hedhë kërkesa e konsideron si të drejtë por për arsye të ndryshme. Meqë bartësi i të drejtës pronësore në mënyrë të pakontestueshme e ka humbur posedimin e parcelës më uzurpimin e saj nga paraqitësi i parë i kërkesës dhe kjo ishte drejtëpërsëdrejti lidhur me luftën, kërkesa bie mbrenda jurisdiksionit të KKPK-ës/Kolegjit të Apelit të AKP-ës. Sidoqoftë është fakt që në vitin 2009 nëna e paraqitësit të kërkesës si bartës i të drejtës pronësore i ka shitur palujtshmëritë palës së dytë përgjegjëse. Ajo kishte lidhur një para-kontratë me palën e dytë përgjegjëse dhe bile kishte pranuar pagesen në shumë prej € 30. 000. Këto fakte janë të pakontestueshme. Vetë paraqitësi i kërkesës pretendon se pala e dytë përgjegjëse nuk i ka përmbushur ende obligimet e veta që dalin nga kontrata d.m.th se ai nuk ka paguar ende plotësisht çmimin e pronës. Ai nuk e konteston faktin se bartësja e të drejtës pronësore kishte dëshiruar ta bartte pronësinë e saj. Në rastet si këto gjykata nuk gjen interesin ligjor për të proceduar ërkesën para KKPK-ës/Kolegjit të Apelit të AKP-ës dhe se kërkesa duhet të hedhet (ashtu siq edhe është bërë nga isnatanca e parë por për arsye të tjera). Sipas nenit 2.4 të Ligjit mbi Procedurën Kontestimore pala duhet të ketë interesin ligjor në kërkesën e paraqitur dhe procedurën tjetër ligjore. Konkretisht në këtë rast paraqitësi i kërkesës ka interes ligjor në kërkesën monetare që ka të bëjë me pagesen e plotë të çmimit të shitjes së pronave ose që kontrata/parakontrata të anulohet duke kthyer shumën e parave të pranuar.

Me qëllim të qartësimi faktik do të mund të shpjegohej që përmes përgjigjes dhënë ndaj palës së paditur adresuar AKP-ës 20 shtator 2011, L.S ka konfirmuar faktin se është e vërtetë Deklarata vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë Vr.nr.9680/09 i dt.30 dhjetor 2009 ,duke pohuar se me shprehjen e vullnetit të sajë dhe pa përdorimin e kërcënimit, dhunës si dhe me pëlqimin e anëtarëve të familjes së sajë ka shitur A.Sh.K pronën e paluajshme të regjistruar në Fletën Poseduese nr.36, në sipërfaqe të përgjithshme prej 2.91,81 ha, që gjendet në zonën kadastrale Shaptejë, Komuna e Deçanit, me çmim prej 175.000 euro e që do të paguhet në tri këste. Kësti i parë prej 30.000 euro menjëherë ,kësti i dytë prej 100.000 euro me dt.25

nëntor 2010, dërkaq kësti i tretë me 20 dhjetor 2010 në shumë prej 45.000.euro .Vetëm kësti i parë është paguar. Me këtë deklaratë po kështu konstatohet që këto prona bujqësore i dorëzohen blerësit në posedim dhe ai ka të drejtë ta vërtetojë kontratën e shitblerjes në gjykatën kompetente dhe ta regjistrojë ato prona në kadastër në emrin e tij.

Vet L.S në cilësinë e titullarit të së drejtës së pronësisë duke dorëzuar në Gjykatën Supreme përgjigjen ndaj palës së paditur adresuar AKP-ës 20 shtator 2011 dhe Deklaratën e vërtetuar në gjykatën Komunale në Pejë Vr.nr.9680/09 i dt.30 dhjetor 2011, pranon se këto ngastra ishin shitur palës përgjegjëse në kërkesë-ankesë me dt. 30 dhjetor 2009, por se blerësi ka paguar vetëm kështun e parë prej 30.000 euro, qe është çmim i pjesshëm të çmimit të shitblerjes së atyre paluajtshmeëve..Prandaj ,nuk ka prova se këto ngastra janë humbur dhe nuk mund të ushtrohet e drejta e pronësisë për shkak të konfliktit të armatosur. Por përkundrazi ekziston kontesti lidhur me këtë pronë e paluajtshme në mes të sajë dhe A.Sh.K për shkak se ai nuk ka vepruar në pajtim me marrëveshjen që e kanë pasur. KKPPK rrjedhimisht edhe Gjykata Supreme është e kufizuar ekskluzivisht në kërkesat për vërtetimin pronësisë dhe kthimin e posedimit për shkak të rrethanave që lidhen drejtpërdrejt apo rezultojnë nga konflikti i armatosur në Kosovë 1998/1999.

Po kështu deklarata L.S e vërtetuar në gjykatën Komunale në Pejë Vr.nr.9680/09 i dt.30 dhjetor 2011 dhe autorizimi i vërtetuar në të njëjtën gjykatë janë shprehje e autonomisë së vullnetit të sajë përderisa nuk vërtetohet me prova juridikisht të vlefshme dhe nga gjykata kopetente se e njëjtat janë të nulitetit absolut apo të atij relativ. Pra, derisa nuk vërtetohet e kundërta këto prova janë juridikisht e vlefshme dhe prodhojnë efekt juridik inter partes-në mes të palëve kontraktuese.

Prandaj, në këtë çështje juridike- kontestimore paraqitësi i kërkesave nëse ka interes juridik ashtu siç edhe u theksua më lartë, paraqitësi i kërkesës ka të drejtë dhe mundësi ligjore për të kërkuar mbrojtje gjyqësore para gjykatave kopetente lidhur me përmbushjen apo zgjidhjen së autorizimit, deklaratës të vërtetuar në gjykatë komunale në Pejë Vr.nr.9679/09 dhe 9680/09 të dt.30 dhjetor 2009 dhe kontratës së shitjes së pronave të pajuajtshme të vërtetuar nga Gjykata Komunale në Deçan Vr.nr.2996/09 i dt.31 dhjetor 2009 dhe rrjedhimisht kthimin e paluajtshmeëve që janë objekt i kërkesave.

Prandaj rrjedhimisht mbi të mësipërme sipas dispozitës së nenit nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079 vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës:

Në bazë të Shtojcës III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrativ (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një

përfundim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksës gjyqësore të paraparë me Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, tarifatat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Taksa nga tarifa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): € 30
- Taksa nga tarifa gjyqësore për nxjerrjen e aktgjykimit (nenet 10.21, 10.15 dhe 10.1 të UA 2008/2) duke pasur parasysh se vlera e pronës në fjalë në mënyrë të arsyeshme mund të përlloraget të jetë mbi € 90.000: € 500 (€ 50 + 0.5% nga 90.000, por jo më shumë se € 30).

Këto tarifa gjyqësore duhet të merren përsipër nga ankuesi që humb rastin. Në përputhje me nenin 46 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e taksave në fjalë nga personi i cili ka vendqëndrim ose vendbanim jashtë vendit nuk mund të jetë më i shkurtër se 30 ditë e më i gjatë se 90 ditë. Gjykata Supreme vendos që në rastin konkret, shpenzimet gjyqësore duhet të paguhen nga ankuesi në afat prej 30 ditësh nga dita kur aktgjykimi i është dorëzuar atij. Neni 47.3 të këtij Ligji parashikon që në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, pala duhet të paguajë një gjobë prej 50% të shumës së gjobës. Në rast se pala nuk i paguan taksat brenda afatit të dhënë, atëherë bëhet përmbarimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Ky aktgjykim nuk e përjashton të drejtën e paditësit për t'i referuar kërkesat të gjykatat kompetente jashtë juridiksionit të parashikuar me dispozitat e nenit 3.1 Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079.

Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Elka Ermenova, Gjyqtare e EULEX-it

Urs Nufer, Referent i EULEX-it